REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË

Nr._____prot. Lushnjë, më ____/_____/ 2026

Lënda: SHPALLJE PËR POZICIONIN: TRAJNER (EKSPERT) PËR EMERGJENCAT CIVILE

Bashkia Lushnjë shpall hapjen e aplikimeve për pozicionin "Trajner për Emergjencat Civile", në kuadër të rritjes së kapaciteteve për përballimin dhe menaxhimin e situatave emergjente.

Objekti i punës: Trajneri për emergjencat civile do të jetë përgjegjës për planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e trajnimeve për stafin dhe grupet vullnetare, si dhe koordinimin dhe pjesëmarrjen aktive në rastet e emergjencave, përfshirë zjarret, në bashkëpunim me strukturat përkatëse.

Detyrat kryesore:
Hartimi dhe zbatimi i programeve të trajnimit në fushën e emergjencave civile
Trajnimi i stafit dhe grupeve vullnetare për reagimin në situata emergjente
Organizimi i simulimeve dhe ushtrimeve praktike
Koordinimi dhe pjesëmarrja në operacionet në terren, veçanërisht në rastet e zjarreve
Monitorimi dhe vlerësimi i efektivitetit të trajnimeve
Bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse në nivel lokal dhe kombëtar.

Kriteret e kërkuara:
Arsim i lartë
Eksperiencë pune në fushën e emergjencave civile ose në trajnim
Aftësi shumë të mira organizative dhe komunikimi
Njohuri mbi legjislacionin për emergjencat civile
Aftësi për të punuar në grup dhe në kushte presioni

Dokumentacioni i nevojshëm:
Letër motivimi
Kopje e diplomës dhe librezes se punes
Afati i aplikimit: 18/ 05/ 2026
Aplikimet dorëzohen pranë Bashkisë Lushnjë
Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen për fazën e intervistës.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE